

“Secili qytetar ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e shtetit të tij/saj, në mënyrë të drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë përmes të zgjedhurve të tij/saj. Secili qytetar ka të drejtë të qasjes së barabartë në shërbimet publike të shtetit të tij”

*- Deklarata Universale
e të Drejtave të Njeriut, Nenin 21*

**Merr Pjesë – Bëhu pjesë e
vendimmarrjes**

**Një votues i informuar është
votues i fuqishëm – Merr Pjesë**

“1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.- Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – përgatit dhe shpall procedurat zgjedhore; krijon dhe mban listën e votuesve; regjistron dhe certifikon garuesit e zgjedhjeve; përpilon fletëvotimet dhe materialet tjera zgjedhore; akrediton vëzhguesit e zgjedhjeve; certifikon dhe publikon rezultatet e zgjedhjeve; themelon Komisionet Komunale Zgjedhore;

Sfidoje listën e votuesve që ajo të jetë e pastër – Merr pjesë

Pavarësia dhe fuqizimi i organeve të zgjedhjeve janë parakusht për zgjedhje të lira dhe të drejta

“Votimi Familjar” paraqitet në rastet kur një anëtar i gjinisë mashkullore në familje, shoqëron një apo më shumë të afërm të gjinisë femërore në Kabinën e Votimit; ia mohon gjinisë femërore ushtrimin e të drejtës ekskluzive – votimin e lirë, të fshehtë dhe të pavarur të siguruar me ligj.

Trupat menaxhuese të zgjedhjeve në Kosovë janë autoritete të pavarura që organizojnë procesin zgjedhor dhe garantojnë që zgjedhjet të mbahen në mënyrë të drejtë, të lirë, të paanshme dhe duke i respektuar ligjet në fuqi.

Lista e votuesve paraqet listën ku janë të vendosur emrat e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote në Republikën e Kosovës.

Lista përveq të dhënave personale të votuesit specifikon edhe adresën dhe Qendën e Votimit ku votuesit paraprakisht i është caktuar për të votuar. Lista e Votuesve (LV) paraqet ekstraktin e fundit që ka në dispozicion Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë.